



Qendra e Informacionite Aarhus – Vlorë, është një organizatë Jo Fitimprurese e themeluar në 16 Janar 2009 nga bordi i saj drejtues i përbërë nga përfaqësues të Insitucioneve Publike Vendim-marrëse dhe nga përfaqësues të Shoqërisë Civile. Organizata është regjistruar në Gjykatën Civile të Tiranës në 20 Mars, 2009, me nr. Vendimi 520.

Misioni i Organizatës;

Të promovojë mekanizmat e pjesëmarrjes dhe partneritet midis autoriteteve qendrore dhe lokale publike, organizatave të Shoqërisë Civile dhe komunitetit, të biznesit dhe grupeve të tjera për çështje të mjedisit dhe mirëqeverisjes si dhe sfidat e sigurisë në nivel lokal, kombëtar dhe rajonal përmes mbështetjes e zbatimit në praktik të tri shtyllave të Konventës së Aarhusit:

- a. E drejta e Informimit Publik;
- b. E drejta e Pjesëmarrjes së Publikut në vendim-marrje;
- c. E drejta e Ankimimit Ligjor.

Vizioni i Organizatës:

Forcimi i bashkëpunimit midis qytetarëve, Shoqërisë Civile, grupeve të interesit dhe Institucioneve Publike për të pasur vendime transparente përmes informimit dhe pjesëmarrjes qytetare në vendim-marrje, përkraja e iniciativave qytetare dhe të grupeve të interesisit për përfshirjen e zërit qytetar, ideve, sugjerimeve dhe mendimeve të komunitetit në planet, programet dhe projektet që kanë ndikim në jetën e komunitetit. Lehtësimi i diskutimeve midis zyrtarëve lokal dhe qytetarëve për zgjidhjen e çështjeve lokale mjedisore, përmes dialogut konstruktiv dhe mjeteve demokratike.

THIS PROJECT IS FUNDED BY THE EUROPEAN UNION

The views expressed in this publication do not necessarily reflect the views of the European Commission



Hyrje

Në kuadër të projektit: ***“Iniciativat në fushën e Energjive të Rinovueshme, një hap i rëndësishëm drejt Zhvillimit të Qëndrueshëm”***, me mbështetjen e env.net dhe Co-PLAN u bë finalizimi i një procesi një vjeçar, në bashkëpunim edhe me Pushtetin Lokal, Shoqërinë Civile dhe grupet e interesit, në lidhje me efikasitetin dhe rëndësinë e Energjive të Rinovueshme në Bashkitë e Komunitetave të Qarkut të Vlorës. Marrja e mendimit qytetar dhe e grupeve të tjera të interesit, biznesit lokal dhe Shoqërisë Civile, e koordinuar kjo edhe me konkluzionet e marra në tryezat e rrumbullakta dhe forumet publike me të gjitha grupet e interesit solli përgatitjen e disa rekomandimeve. Këto rekomandime që AIC-Vlorë i konsideron shumë të rëndësishme, janë për t’u marrë në konsideratë nga Njësitë e Qeverisjes Vendore në Qarkun e Vlorës, me qëllim zhvillimin e potencialeve në fushën e Energjive të Rinovueshme. Fakti që në zonën jugore të Shqipërisë ka rreth 300 ditë me diell në vit, bënë që dhe potencialet për zhvillimin e Energjive të Rinovueshme të jenë shumë të larta, potenciale të cilat nëse do të shfrytëzoheshin si nga bizneset private edhe nga banorët më gjerë do të sillnin një pavarësi shumë të madhe ndaj rrjetit të Energjisë Elektike dhe njëkohësisht edhe kursim të konsiderueshëm në faturat e tyre elektrike.

Sigurisht që procesi ka filluar herët nga AIC Vlorë, qysh në Shtator të vitit 2013, me projektin e mbështetur dhe financuar nga OSBE – Prezenca në Shqipëri: ***“Mbështetja e integritetit mjedisor dhe mekanizmave të konsultimit publik në politikat dhe projektet e qeverisjes qendrore dhe vendore”***, të organizuar në bashkëpunim edhe me Njësitë vendore të Orikumit, Himarës, Sarandës, Lukovës dhe Ksamilit si edhe UNDP - zyra në Tiranë, duke u fokusuar në perspektivat e Energjive të Rinovueshme në këto njësi vendore por edhe të Jugut të Shqipërisë në përgjithësi. U realizuan disa tryeza të rrumbullakëta, forume publike, sondazhe publike dhe takime me qytetarë e grupe interesi për të diskutuar mbi mundësitë reale për zhvillimin e projekteve në fushën e Energjive të Rinovueshme. Projekti i nisur qysh në Shtator 2013, ka gjetur përkrahjen

THIS PROJECT IS FUNDED BY THE EUROPEAN UNION

The views expressed in this publication do not necessarily reflect the views of the European Commission



edhe të qytetarëve në Bashkitë përkatëse në saj të krijimit të grupeve të organizuara qytetare në formën e Komisioneve Këshillimore Qytetare, të cilët kanë qenë shumë aktivë përgjatë realizimit të aktiviteteve të projektit.

Zbatimi i këtij projekti përputhet me objektivat strategjike të Organizatës të cilat janë:

- (i) Inkurajimi transparencës më të madhe në proceset vendim-marrëse në planifikimin lokal dhe implementimin e projekteve që kanë ndikim në mjedis dhe në shëndetin e komunitetit;
- (ii) Ndërtimi i sistemeve të qëndrueshme për shpërndarjen në kohë të informacionit publik në lidhje me vendimet e ardhshme të planifikimit të institucioneve shtetërore që ndikojnë në mjedis dhe shëndetin e komunitetit, për të lehtësuar angazhimin aktiv të qytetarëve, Shoqërisë Civile dhe të aktorëve të tjerë në konsultimet publike;
- (iii) Ndërtimi i kapaciteteve të qytetarëve, zyrtarëve shtetërorë, sektorit privat dhe aktorëve të tjerë për të marrë pjesë aktive në proceset konsultative lokale të planifikimit në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre përkatëse, siç përcaktohet nga kushtetuta dhe marrëveshjet përkatëse ndërkombëtare;
- (iv) Inkurajimi i Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe të orientuar drejt pjesëmarrjes qytetare në vendim-marrje, në procesin e planifikimit dhe programimit në nivel lokal duke promovuar kështu parimet e mirë - qeverisjes, transparencës dhe llogaridhënies.

Falë bashkëpunimit me aktorët lokalë vendim-marrës në Bashkitë Sarandë, Himarë dhe Orikum, mendimit qytetar dhe të grupeve të interes dhe Shoqërisë Civile janë hartuar disa rekomandime për njësitë vendore të sipërpërmendura me qëllim që të merren në konsideratë për zhvillimin e Energjive të Rinovueshme.

Proçesi i hartimit të Rekomandimeve në fushën e Energjive të Rinovueshme ishte transparent, i hapur dhe me pjesëmarrje të gjerë qytetare, të zyrtarëve publikë lokalë, grupeve të interes dhe Shoqërisë Civile.

THIS PROJECT IS FUNDED BY THE EUROPEAN UNION

The views expressed in this publication do not necessarily reflect the views of the European Commission



Një falenderim i veçantë shkon për UNDP – Prezenca në Shqipëri dhe znj. Mirela Kamberi, të cilët dhanë mundësinë e implementimit në praktik të këtij projekti duke bërë instalimin e paneleve diellore për ujin e ngrohtë në institucone publike të Bashkive Orikum, Himarë dhe Sarandë, përkatësisht Klubi sportiv Orikum, Klubi sportiv Himarë dhe Kopshti nr. 3 e Konvikti i Shkollës së Mesme Tregëtare në Sarandë.

THIS PROJECT IS FUNDED BY THE EUROPEAN UNION

The views expressed in this publication do not necessarily reflect the views of the European Commission



Rekomandime

- Të rritet fryma e bashkëpunimit midis pushtetit lokal dhe grupeve të interesit, shoqërisë civile lokale, bizneseve private dhe të gjithë komunitetit, duke krijuar mardhënie të qëndrueshme midis tyre.
- Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit për të mirat që sjell përdorimi i burimeve të rinovueshme si nga ana financiare edhe nga ajo mjedisore. Fushatat ndërgjegjëse mund të bëhen me mënyra të ndryshme, si p.sh. spotet publicitarare në mediat lokale dhe qendrore, fletëpalosje, etj.
- Sigurimin e informacioneve të plota nga inxhinierë dhe specialistë të varur nga Bashkia/Komuna, në mënyrë të tillë që të bëhet një vlerësim paraprak për efikasitetin e përdorimit të një burimi të energjisë së rinovueshme të caktuar.
- Vënia në dispozicion të publikut të shfrytëzimeve të deri tanishme të burimeve të rinovueshme, sa të efektshme kanë qenë ato dhe sa kursim energjie mund të bëhet nga fatura aktuale e energjisë.
- Mbështetja dhe inkurajimi i bizneseve private të cilat janë duke zëvendësuar një pjesë të energjisë elektrike me atë kryesisht diellore (hotelet përdorin panalet diellore për ngrohjen e ujit), me anë të incentivave financiare apo shtimit të sipërfaqes së paneleve për ta shtrirë shfrytëzimin e energjisë diellore edhe për ndriçim apo aktivitete të tjera.
- Implementimin e projekteve të ndryshme, pa kosto të mëdha, por që tejkalojnë kuadrin teorik dhe shërbejnë si një shembull pozitiv për të gjithë komunitetin dhe

THIS PROJECT IS FUNDED BY THE EUROPEAN UNION

The views expressed in this publication do not necessarily reflect the views of the European Commission



krijimin e Draft projekteve për planifikimin dhe zhvillimin e energjisë së rinovueshme në nivel lokal.

- Kryerjen e studimeve të ndryshme në zona që kanë potenciale të mëdha për zhvillimin e energjive të rinovueshme duke synuar dhe tërheqjen e investorëve të ndryshëm qofshin ata të huaj apo vendas.
- Përfshirja në Buxhetin e Bashkive apo të Komunave (me një vlerë prej 10% të buxhetit) të Energjive të Rinovueshme duke favorizuar zhvillimin e tyre në nivel lokal.
- Hartimin e rekomandimeve për Pushtetin Lokal dhe Qëndror, të cilat do të shërbejnë për përgatitjen e akteve nënligjore përkatëse dhe do të reflektojnë realitetin në terren.
- Organizimi i tryezave të rrumbullakëta/seminareve/trajnimeve mbi çështjet e Energjive të Rinovueshme, në bashkëpunim me Organizatat e Shoqërisë Civile, Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, Agjensinë Kombëtare të Burimeve Natyrore për qytetarët, grupet e intersit, pushtetin lokal, etj.

Qendra e Informacionit Aarhus Vlorë

Adresa: Lagja "Hajro Cakërri", Bulevardi "Ismail Qemali", Kulla e Ferhatit, Pranë Stadiumit "Flamurtari", Kati IV - Vlorë, Albania;

Tel/Fax: +355 33400182. E-mail: aicvlore@gmail.com

Website: www.aic-vlore.org

THIS PROJECT IS FUNDED BY THE EUROPEAN UNION

The views expressed in this publication do not necessarily reflect the views of the European Commission

